L I G J
Nr. 8820, datë 27.9.2001

PËR RATIFIKIMIN E "MARRËVESHJES SË KREDISË TË ZHVILLIMIT NDËRMJET QEVERISË SË REPUBLIKËS TË SHQIPËRISË DHE SHOQATËS NDËRKOMBËTARE PËR ZHVILLIM (IDA) PËR PROJEKTIN "SHPËRNDARJA E SHËRBIMEVE SOCIALE""

Në mbështetje të neneve 78, 81, 83 pika 1, 2 dhe 121 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

K U V E N D I

I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË
V E N D O S I:

Neni 1

Ratifikohet "Marrëveshja e kredisë të zhvillimit ndërmjet Qeverisë së Republikës të Shqipërisë dhe Shoqatës Ndërkombëtare për Zhvillim (IDA), për projektin "Shpërndarja e shërbimeve sociale"".

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Shpallur me dekretin nr. 3115, datë 3.10.2001 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Rexhep Meidani

Numri i Kredisë 3513 Shqipëri

MARRËVESHJA
E KREDISË SË ZHVILLIMITNDËRMJET SHQIPËRISË DHE SHOQATËS NDËRKOMBËTARE PËR ZHVILLIMPROJEKTI I SHPËRNDARJES SË SHËRBIMEVE SOCIALE

DATË 3 KORRIK, 2001

MARRËVESHJA e datës 3.7.2001, ndërmjet REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË (Huamarrësi) dhe SHOQATËS NDËRKOMBËTARE PËR ZHVILLIM (Shoqata).

Ndërsa, (A) Huamarrësi, pasi ka mbetur i kënaqur me zbatueshmërinë dhe prioritetin e projektit që përshkruhet në Seksionin 2 të kësaj Marrëveshjeje i ka kërkuar Shoqatës ta ndihmojë në financimin e këtij Projekti;

(B) Humarrësi do të marrë financime grant nga Departamenti për Zhvillim Ndërkombëtar i Britanisë së Madhe për shumën dy milionë e pesëqind mijë dollarë ($ 2,500,000) Grant i DFID-it) për të ndihmuar në financimin e Pjesëve A.2, B dhe C.2 të Projektit sipas termave dhe kushteve të

përcaktuara në një marrëveshje që do të firmoset midis Huamarrësit dhe DFID (Marrëveshja e Grantit me DFID-in);

Ndërsa Shoqata midis të tjerash ka rënë dakord mbi bazën e sa më sipër t'i japë një Kredi Humarrësit mbi bazën e afateve kohore dhe kushteve të përcaktuara në këtë Marrëveshje;

Në bazë të sa më sipër, palët e mësipërme bien dakord për sa më poshtë:

Neni 1
Kushtet e Përgjithshme; përkufizimet

Seksioni 1.01. “Kushtet e Përgjithshme të Marrëveshjeve të Kredisë së Zhvillimit” të Shoqatës të datës 1 janar, 1985 (siç janë ndryshuar deri më 6 tetor 1999) me modifikimet e mëposhtme (Kushtet e Përgjithshme) përbëjnë një pjesë të pandarë të kësaj Marrëveshjeje.

(a) Një paragraf i ri (12) i shtohet Seksionit 2.01 me përmbajtjen e mëposhtme dhe për pasojë paragrafëve ekzistues (12) deri në (14) të këtij Seksioni do t’u vendosen numra të rinj dhe do të bëhen paragrafet (13) deri në (15);

“12. “Vend Pjesëmarrës” do të thotë çdo vend që për Shoqatën përmbush kushtet e përcaktuara në Seksionin 11 të Rezolutës nr.194 të Bordit të Guvernatorëve të Shoqatës së aprovuar më 8 prill 1999; dhe “Vendet Pjesëmarrëse” do të quhen me një emër (së bashku) të gjitha këto vende”; dhe

(b) Fjalia e dytë e Seksionit 5.01 është ndryshuar me përmbajtjen e mëposhtme:

“ Me përjashtim të rasteve kur Huamarrësi dhe Shoqata bien dakord të veprojnë ndryshe, nuk do të bëhet asnjë tërheqje: (a) për shpenzime në territorin e një vendi që nuk është Vend Pjesëmarrës apo për mallra të prodhuara dhe shërbime të siguruara nga këto territore; ose (b) për qëllime pagesash të çfarëdo lloji përkundrejt personave apo njësive, apo për import mallrash, në rast se kjo pagesë apo ky import, me sa është në dijeni Shoqata, është i ndaluar me një vendim të Këshillit të Sigurisë të Kombeve të Bashkuara sipas Kapitullit VII të Kartës të Kombeve të Bashkuara.”

Seksioni 1.02. Vetëm në ato raste kur kërkohet ndryshe nga konteksti, afatet e përcaktuara në Kushtet e Përgjithshme dhe në Hyrjen e kësaj Marrëveshjeje kanë kuptimet përkatëse të përcaktuara më poshtë:

(a) “Përfitues” do të thotë çdo komunitet, organizatë apo agjenci e zgjedhur për të përfituar asistencë në kontekstin e Projektit;

(b) “Kategoritë e përzgjedhura” janë kategoritë nga (1) deri në (4) të përcaktuara në tabelën e Pjesës A.1 të Skedulit 1 të kësaj Marrëveshjeje;

(c) “Shpenzime legjitime” janë shpenzimet për mallra dhe shërbime të cilave iu referohet Seksioni 2.02 i kësaj Marrëveshjeje;

(d) “APNSHS” do të thotë Administrata e Përgjithshme e Ndihmës dhe Shërbimeve Sociale, e cila është agjenci që funksionon brenda Ministrisë së Punës dhe Çështjeve Sociale të Huamarrësit;

(e) “Agjencia zbatuese” ka kuptimin e çdo organizate apo agjencie me bazë komuniteti e evidentuar nga një përfitues për të qenë përgjegjës për zbatimin e një nënprojekti në emër të një Përfituesi;

(f) “Mis” do të thotë Sistemi i Menaxhimit të Informacionit dhe përfshin një “software” të vendosur/caktuar nga Humarrësi për të siguruar të dhënat aktuale për treguesit e monitorimit të projektit dhe ecurinë në zbatimin e Projektit;

(g) “Manuali i punës” ka kuptimin e manualit, të kënaqshëm për shoqatën, ku përcaktohen rregullat dhe procedurat për zbatimin e Projektit, duke përfshirë kriteret e përzgjedhjes për nënprojektet dhe sigurimin e granteve për shërbimet e përkujdesjes sociale me bazë komuniteti dhe funksionimin e PCU-së;

(h) “PCU-ja” është Njësia e Koordinimit të Projektit, ngritur dhe mbajtur nga Huamarrësi brenda APSH-së në përputhje me dispozitën e paragrafit 7 të Skedulit 4 të kësaj Marrëveshjeje për qëllimet e menaxhimit të Projektit.

(i) “Raport i menaxhimit të projektit” është çdo raport që përgatitet në përputhje me Seksionin 4.02 të kësaj Marrëveshjeje;

(j) “Komisioni për aprovimet rajonale” është komisioni që të organizohet në çdo rajon pjesëmarrrës me pjesëmarrjen e përfaqësuesve nga çdo pushtet rajonal, komunitet përftuesish dhe shoqëria civile;

(l) “Llogaria Speciale” është llogaria e përmendur në Pjesën B të Skedulit I të kësaj Marrëveshjeje; dhe

(m) “Nënprojekt” ka kuptimin e një sërë aktivitetesh që do të kryhen nga një Agjenci Zbatimi në përdorim të asistencës që i është dhënë në dispozicion Përftuesit.

Neni 2
Kredia

Seksioni 2.01. Shoqata bie dakord t'i huajë Humarrësit, sipas afateve dhe kushteve të përcaktuara apo të referuara në Marrëveshjen e Kredisë së Zhvillimit, një shumë në monedha të ndryshme të barabarta me shtatë milion e nëntëqind mijë të Drejta Speciale tërheqjeje (SDR 7,900,000).

Seksioni 2.02. (a) Shuma e Kredisë mund të tërhiqet nga Llogaria e Kredisë në përputhje me dispozitat e Skedulit I të kësaj Marrëveshjeje për shpenzimet e bëra (ose për shpenzimet që do të bëhen në rast se bie dakord Shoqata) për kosto të arsyeshme mallrash dhe shërbimesh që kërkohen për Projektin dhe që do të financohen nga Kredia.

Seksioni 2.03. Data e Mbylljes së Kredisë do të jetë 31 mars 2008 ose ndonjë datë e mëvonshme që do të përcaktohet nga Shoqata. Shoqata do të njoftojë Huamarrësin momentin e duhur për këtë datë të mëvonshme.

Seksioni 2.04. (a) Huamarrësi do t'i bëjë Shoqatës një pagesë të detyruar mbi shumën kryesore të Kredisë që nuk është tërhequr herë pas here në një shumë që do të përcaktohet nga Shoqata në datën, 30 qershor të çdo viti, por që nuk duhet të kalojë gjysëm për qind (1/2 e 1% për vit).

b) Shuma e detyruar do të rritet; (i) pas gjashtëdhjetë ditëve nga data e kësaj Marrëveshjeje (data e interesit) deri në datat respektive në të cilat do të tërhiqen ose anulohen nga Huamarrësi shumat nga Llogaria e Kredisë; dhe (ii) në shumën e caktuar në 30 qershor, menjëherë përpara datës së interesit dhe me shuma të tjera siç mund të caktohen herë pas here në bazë të paragrafit (a) më sipër. Shuma e caktuar më datë 30 qershor të çdo viti do të zbatohet që nga data tjetër e atij viti, datë kjo e përcaktuar në Seksionin 2.06 të kësaj Marrëveshjeje.

(c) Shuma e detyruar do të paguhet: (i) në vende të tilla që kërkon Shoqata brenda arsyes; (ii) pa kufizime të çdo lloji të vendosura në territorin e Huamarrësit; dhe (iii) në monedhën e specifikuar në këtë Marrëveshje për qëllimet e Seksionit 4.02 të Kushteve të Përgjithshme apo në ndonjë monedhë apo monedha të tjera të përshtatshme që mund të caktohen ose përzgjidhen herë pas here sipas dispozitave të atij Seksioni.

Seksioni 2.05. Huamarrësi duhet t'i paguajë Shoqatës një tarifë shërbimi prej tre të katërtave të një për qind (3/4 e 1%) në vit mbi shumën principale të Kredisë së tërhequr dhe të papaguar herë pas here.

Seksioni 2.06. Shumat e detyrueshme dhe ato të shërbimit do të jenë të pagueshme çdo gjashtë muaj më 15 janar dhe 15 korrik të çdo viti.

Seksioni 2.07. (a) Në bazë të paragrafeve (b), (c) dhe (d) më poshtë, Huamarrësi do të paguajë shumën principale të Kredisë me këste gjashtë mujore të pagueshme në çdo 15 janar dhe 15 korrik duke filuar nga 15 korrik 2011 dhe duke përfunduar më 15 janar 2001. Çdo këst duke përfshirë këstin e pagueshëm më 15 janar 2021 do të jetë një për qind (1%) e kësaj shume principale dhe çdo këst i mëvonshëm do të jetë dy për qind (2%) e kësaj shume principale.

(b) Kur (i) prodhimi i përgjithshëm kombëtar për frymë (GNP-ja) e Huamarrësit, siç është vendosur nga Shoqata do të ketë kaluar për tre vjet rresht një pas një nivelin e përcaktuar për vit nga

Shoqata; dhe (ii) Banka do t'a konsiderojë Huamarrësin të vlefshëm për t'i dhënë kredi, Shoqata mundet që pas rishikimit dhe aprovimit nga drejtorët rkzekutivë të Shoqatës dhe pas një periudhe konsiderimi nga ana e tyre të zhvillimit të ekonomisë të Huamarrësit, të modifikojë pagesën e kësteve në bazë të paragrafit (a) më sipër:

(A) duke i kërkuar Huamarrësit të shlyejë dyfishin e shumës të secilit prej këtyre kësteve që nuk janë bërë ende për t'u paguar deri kur të paguhet shuma principale e Kreditit; dhe

(B) duke i kërkuar Huamarrësit të fillojë pagesën e shumës principale të Kredisë që nga data e parë e pagesës gjysmë vjetore për të cilën bëhet fjalë në paragrafin (a) më sipër, pas gjashtë apo më shumë muajsh pas datës në të cilën Shoqata njofton Huamarrësin që kanë ndodhur ngjarjet e përcaktuara në paragrafin (b), duke patur parasysh që do të ketë një periudhë faljeje (grace period) prej një minimumi pesë vjetësh mbi këtë shlyerje të principalit.

(c) Nëse kërkohet nga Huamarrësit, Shoqata mund të rishikojë modifikimet e referuara në paragrafin (b) më sipër që të përfshijnë disa ose të gjitha rritjet në shumat e kësteve të tilla, pagesën e interesit në një tarifë vjetore të rënë dakord me Shoqatën mbi shumën principale të Kredisë të tërhequr herë pas here, duke patur parasysh që në bazë të gjykimit të Shoqatës një rishikim i tillë nuk do të ndryshojë elementin e grantit që është marrë në bazë të modifikimit të mësipërm të shlyerjes.

(d) Nëse në ndonjë moment pas modifikimeve të termave në bazë të paragrafit (b) më sipër, Shoqata vendos që kushti ekonomik i Huamarrësit është përkeqësuar në mënyrë të ndjeshme, në rast

se kërkohet nga Huamarrësi, Shoqata mundet të modifikojë më tej termat e pagesës për të qenë konform skedulit të kësteve siç paraqitet në paragrafin (a) më sipër.

Seksioni 2.08. Për qëllimet e Seksionit 4.02 të Kushteve të Përgjithshme specifikohet monedha e Shteteve të Bashkuara të Amerikës.

Neni 3
Zbatimi i Projektit

Seksioni 3.01. (a) Humarrësi deklaron angazhimin e tij ndaj objektivave të Projektit, të përcaktuara në Shtojcën 2 të kësaj Marrëveshjeje. Për këtë qëllim, Huamarrësi do të zbatojë Projektin me kujdesin/zellin dhe efikasitetin e duhur, si edhe në përputhje me praktikat e përshtatshme financiare, administrative, mjedisore dhe teknike. Humarrësi do të sigurojë menjëherë, sipas nevojës, fondet, lehtësitë dhe burimet e tjera të kërkuara nga Projekti.

(b) Pa u kufizuar nga dispozitat e paragrafit (a) të këtij Seksioni dhe me përjashtim të atyre rasteve kur Huamarrësi dhe Shoqata bien dakord për ndryshe, Huamarrësi do të zbatojë Projektin në përputhje me Programin e Zbatimit, të përcaktuar në Skedulin 4 të kësaj Marrëveshjeje.

Seksioni 3.02. Me përjashtim të atyre rasteve kur Shoqata bie dakord përndryshe, prokurimi i mallrave, punimeve dhe shërbimeve të konsulentëve që kërkohen në kuadrin e Projektit dhe që do të financohen nga Kredia do të qeverisen nga dispozitat e Skedulit 3 të kësaj Marrëveshjeje.

Seksioni 3.03. Për qëllimet e Seksionit 9.06 të Kushteve të Përgjithshme dhe pa u kufizuar me to, Humarrësi:

(a) mbi bazën e udhëzimeve të pranueshme për Shoqatën, do të përgatisë dhe do t'i parqesë Shoqatës një plan për funksionimin e ardhshëm të Projektit jo më vonë se gjashtë (6) muaj pas datës së mbylljes apo ndonjë date tjetër për të cilën mund të jetë rënë dakord midis Humarrësit dhe Shoqatës; dhe

(b) do t'i japë Shoqatës mundësinë për të shkëmbyer mendime mbi këtë plan të Huamarrësit.

Neni 4
Klauzolat financiare

Seksioni 4.01. (a) Huamarrësi do të mbajë një sistem të menaxhimit financiar, duke përfshirë regjistrat dhe llogaritë, si edhe do të përgatisë pasqyrat financiare në një format të pranueshëm për Shoqatën, i cili të jetë i përshtatshëm për të reflektuar veprimtaritë, burimet dhe shpenzimet e lidhura me Projektin.

(b) Humarrësi:

(i) do të mbajë regjistrat, llogaritë dhe pasqyrat financiare të cilave u referohet paragrafi (a) i këtij seksioni, si edhe regjistrat dhe llogaritë për Llogarinë Speciale për çdo vit fiskal të audituar në përputhje me standardet e kontroll- revizionimit të pranueshme për Shoqatën, të aplikuara në mënyrë të qëndrueshme nga revizorë të pavarur të pranueshëm nga Shoqata;

(ii) do të paraqesë/dorëzojë Shoqatës (A) kopje të vërtetuara/certifikuara të pasqyrave financiare që u referohet paragrafi (a) i këtij Seksioni për çdo vit kontroll- revizioni dhe (B) një opinion mbi këto pasqyra, regjistra dhe raporte të kontroll- revizionit nga këta revizorë sipas detajeve të kërkuara, brenda arsyes nga Shoqata, sapo këto të jenë gati, por sidoqoftë jo më vonë se pas gjashtë muajsh nga data e përfundimit të çdo viti të tillë; dhe

(iii) do të paraqesë Shoqatës çfarëdolloj informacioni tjetër në lidhje me këto regjistra dhe llogari, si edhe me revizionimin e tyre, si edhe informacion në lidhje me revizorët sa herë që Shoqata ta kërkojë një gjë të tillë.

(c) Për të gjitha shpenzimet në lidhje me tërheqjet nga Llogaria e Kredisë në bazë të deklaratës të shpenzimeve, Huamarrësi do të:

(i) do të mbajë apo do të shkaktojë mbajtjen e regjistrave dhe llogarive të veçanta që tregojnë këto shpenzime në përputhje me paragrafin (a) të këtij Seksioni;

(ii) do të ruajë për së paku një vit pasi Shoqata të ketë marrë raportin e kontroll-revizionit për vitin fiskal në të cilën është bërë tërheqja e fundit nga Llogaria e Kredisë, të gjitha regjistrat (kontratat, urdhrat, faturat dhe dokumentet e tjra) që vërtetojnë këto shpenzime;

(iii) do t'i vërë këto regjistra në dispozicion të përfaqësuesit të Shoqatës për shqyrtim; dhe

(iv) do të sigurohet që këto regjistra dhe llogari të përfshihen në kontroll-revizionin vjetor të cilit i referohet paragrafi (b) i këtij Seksioni dhe që raporti i këtij kontroll-revizioni të përmbajë një opinion të veçantë nga këta revizorë, nëse deklaratat e shpenzimeve gjatë vitit fiskal në fjalë, së bashku me procedurat dhe kontrollet e brendshme që janë bërë gjatë përgatitjes së tyre të jenë të besueshme për të mbështetur tërheqjet në fjalë.

Seksioni 4.02 (a) Pa u kufizuar në dispozitat e Seksionit 4.01 të kësaj Marrëveshjeje, Huamarrësi do të zbatojë një plan veprimesh me afate kohore që të jetë i pranueshëm për Shoqatën me synimin fuqizimin e sistemit të menaxhimit financiar që iu referuam në paragrafin (a) të Seksionit 4.01 në fjalë me qëllim që Huamarrësi, jo më vonë se data 30 shtator 2001 apo në atë datë të mëvonshme për të cilën do të bjerë dakord Shoqata për të përgatitur raporte tremujore, të pranueshëm për Shoqatën mbi menaxhimin e Projektit. Secili nga këta raporte:

(i) (A) përcakton burimet faktike dhe aplikimet për fondet e Projektit, si në mënyrë kumutative dhe për periudhën e mbuluar nga raporti në fjalë, si edhe burimet e parashikuara dhe aplikimet për fonde nga Projekti për periudhën gjashtëmujore pas periudhës të mbuluar nga raporti në fjalë, dhe (B) të tregojnë në veçanti shpenzimet e financuara nga Kredia gjatë periudhës që mbulon raporti në fjalë dhe shpenzimet e propozuara për t'u financuar nga Kredia gjatë gjashtë muajve pas periudhës të mbuluar nga raporti në fjalë;

(ii) (A) përshkruan progresin fizik në zbatimin e Projektit si në mënyrë kumulative, ashtu edhe për periudhën që mbulon raporti në fjalë dhe (B) shpjegon ndryshimet/mospërputhjet midis synimeve faktike dhe atyre të parashikuara për zbatim; dhe

(iii) përcakton statusin e prokurimeve në kuadrin e Projektit dhe të shpenzimeve sipas kontratave të financuara nga Kredia në fund të periudhës të mbuluar nga raporti në fjalë.

(b) Me përfundimin e planit të veprimeve të përmendur në paragrafin (a) të këtij Seksioni, Huamarrësi në përputhje me udhëzime të pranueshme nga Shoqata do të përgatisë dhe do t'i paraqesë Shoqatës jo më vonë se 45 ditë pas fundit kalendarik të çdo tremujori, një raport mbi Menaxhimin e Projektit për periudhën në fjalë.

Neni 5
Mjetet ligjore të Shoqatës

Seksioni 5.01. Në bazë të Seksionit 6.02 (1) të Kushteve të Përgjithshme, specifikohet ngjarja tjetër e mëposhtme;

(a) Manuali i Punës do të ndryshohet, pezullohet, abrogohet, apo anulohet, si edhe mund të shtohen dispozita të tjera ligjore në mënyrë që të ndikojnë materialisht dhe ndryshe në opinionin e Shoqatës, zbatimin e Projektit.

(b) E drejta e Huamarrësit për të tërhequr nga Granti i DFID-it që i është dhënë Huamarrësit për financimin e Pjesëve A.2, B dhe C.2 të Projektit do të pezullohet, anulohet apo mbyllet, e tëra ose pjesërisht, sipas termave të Marrëveshjes së Grantit me DFID-in; gjithsesi, me kusht që dispozitat e këtij paragrafi të mos aplikohen nëse Huamarrësi e bind Shoqatën që: (i) ky pezullim, anulim apo kjo mbyllje nuk ka ardhur si rrjedhojë e faktit që Huamarrësi nuk ka arritur të kryejë detyrimet e tij sipas kësaj Marrëveshjeje; dhe (ii) fonde të mjaftueshme për Projektin janë në dispozicion të Huamarrësit nga burime të tjera mbi bazë të kushteve dhe termave, në përputhje me detyrimet e Huamarrësit sipas kësaj Marrëveshjeje.

Seksioni 5.02. Sipas Seksionit 7.01 (h) të Kushteve të Përgjithshme, specifikohen evenimentet shtesë të mëposhtme, d.m.th. që do të ndodhë evinimenti i specifikuar në Seksionin 5.01 të kësaj Marrëveshjeje.

Neni 6
Data e hyrjes në fuqi; përfundimi

Seksioni 6.01. Ngjarja e mëposhtme specifikohet si kusht shtesë për hyrjen në fuqi të Marrëveshjes së Kredisë së Zhvillimit brenda kuptimit të Seksionit 12.01 (b) të Kushteve të Përgjithshme, domethënë që Huamarrësi ka aprovuar alokimin e buxhetit të nevojshëm për zbatimin e vitit të parë të projektit.

Seksioni 6.02. Data nëntëdhjetë (90) ditë pas nënshkrimit të kësaj Marrëveshjeje është

specifikuar këtu më poshtë për qëllimet e Seksionit 12.04 të Kushteve të Përgjithshme.

Neni 7
Përfaqësuesi i Humarrësit; adresat

Seksioni 7.01. Ministri i Financave i Huamarrësit është caktuar si përfaqësues i Huamarrësit për qëllimet e Seksionit 11.03 të Kushteve të Përgjithshme.

Seksioni 7.02. Adresat e mëposhtme janë specifikuar për qëllimet e Seksionit 11.01 të Kushteve të Përgjithshme.

Për Huamarrësin:
Ministria e Financave
Bulevardi "Dëshmorët e Kombit"
Tiranë
Shqipëri

Për Shoqatën:
International Development Association
1818 H Street. N.W
Washington, D.C 20433
United States of America

Adresa
Washington.D.C
INDEVAS

Teleks
248423 (MCI) ose
64145 (MCI)

NË PRANI TË DËSHMITARËVE, palët e mësipërme, duke vepruar nëpërmjet përfaqësuesve të autorizuar, kanë firmosur në emrat e tyre përkatës në Distriktin e Kolumbias në Shtetet e Bashkuara të Amerikës, sipas ditës dhe vitit që është shkruar më sipër.

SHQIPËRIA
Nga Fatos Tarifa
Ambasador

Përfaqësuesi i autorizuar
SHOQATA NDËRKOMBËTARE PËR ZHVILLIM
Nga CHRISTIAN POORTMAN

SKEDULI I
TËRHEQJET NGA KREDIA

A. Të përgjithshme

1. Tabela e mëposhtme përcakton Kategoritë e njësive që do të financohen nga Kredia, shpërndarjen e shumave të Kredisë për çdo Kategori dhe përqindjen e shpenzimeve për çdo njësi që do të financohen nga secila Kategori.

Kategoria	Shuma e kredisë së alokuar (shprehur në ekuivalent të SDR)1	% e shpenzimeve që do të financohen
(1) Punime		
(a) për pjesën C.1 të projektit	[1,740,000]	85%
(b) përveç pjesës C.1 të Projektit	(160,000)	75%
(2) Mallra		
(a) për pjesën C.1 të projektit	(1,500,000)	100% e shpenzimeve të huaja, 100% e shpenzimeve lokale (kostoja ex-factory) dhe 85% e shpenzimeve lokale për artikuj të tjerë të prokuruar në vend
(b) përveç pjesës C.1 të Projektit	320.000	

Kategoria	Shuma e kredisë së alokuar (shprehur në ekuivalent të SDR)2	% e shpenzimeve që do të financohen
(3) Shërbimet e konsulencës dhe trajnim		100%
(a) për pjesën C.1 të projektit	1,770,000	85%
(b) përveç pjesës C.1 të Projektit	1,220,000	75%

[1] Shprehur në dollarë, por që do të konvertohen në SDR përpara ose gjatë negociatave.
[2] Shprehur në dollarë, por që do të konvertohen në SDR përpara ose gjatë negociatave.

(4) kosto inkrementale operacionale	790,000	
(5) të paalokuara	400,000	100% e shpenzimeve të huaja, 100% e shpenzimeve lokale (kostoja ex-factory) dhe 85% e shpenzimeve lokale për artikuj të tjerë të prokuruar në vend
Total	7,900,000	

2. Për qëllimet e këtij Skeduli:

(a) termi "shpenzime të huaja" ka kuptimin e shpenzimeve në monedhën e çdo vendi, përveç asaj të Huamarrësit për mallra apo shërbime të furnizuara nga territori i çdo vendi, me përjashtim të atij të Huamarrësit;

(b) termi "shpenzime lokale" ka kuptimin e shpenzimeve në monedhën e Huamarrësit apo për mallra ose shërbime të furnizuara nga territori i Huamarrësit;

(c) termi "kosto operacionale shtesë" ka kuptimin e kostove operacionale shtesë të PCU-së për llogari të zbatimit, menaxhimit dhe monitorimit të Projektit, duke përfshirë pagat e stafit të PCU-së, duke përjashtuar ata që janë nëpunës civilë, komunikim, mirëmbajtjen dhe funksionimin e pajisjeve të Projektit dhe pajisje zyre, trajnime dhe udhëtime studimore dhe shpenzimet për udhëtime në terren për stafin e APNSHS-së dhe MOLSA-s, lidhur me zbatimin dhe monitorimin e Projektit.

3. Pavarësisht nga dispozitat e paragrafit 1 më sipër, asnjë tërheqje nuk do të bëhet për:

(a) pagesa për shpenzime përpara datës së hyrjes në fuqi të kësaj Marrëveshjeje; dhe

(b) pagesa për shpenzime në Kategorinë (3) (b) për shërbime të konsulentëve dhe trajnime, n.q.s. nuk ka hyrë në fuqi Marrëveshja e Grantit me DFID-në.

4. Shoqata mund të kërkojë që tërheqjet nga Llogaria e Kredisë të bëhen në bazë të deklaratave të shpenzimeve për shpenzime, në lidhje me: (i) mallra sipas kontratave që kushtojnë nën USD 50.000; (ii) punime sipas kontratave që kushtojnë më pak se USD 75.000; (iii) shërbime sipas kontratave që kushtojnë më pak se USD 50,000; dhe (iv) kosto inkrementale operacionale sipas termave dhe kushteve që Shoqata do t'ia njoftojë specifikisht Huamarrësit.

B. Llogaria speciale

1. Huamarrësi do të hapë dhe mbajë një llogari të veçantë në dollarë, sipas kushteve të pranuara nga Shoqata, përfshirë mbrojtjen e duhur ndaj kompensimit, sekuestrimit dhe konfiskimit.

2. Pasi Shoqata të jetë informuar se Llogaria Speciale është hapur, tërheqjet nga Llogaria e Kreditimit të shumave që do të depozitohen në Llogarinë Speciale do të bëhen si më poshtë:

(a) derisa Shoqata të ketë marrë (i) raportin e parë të Menaxhimit të Projektit të përmendur në Seksionin 4.02 (b) të kësaj Marrëveshjeje dhe (ii) një kërkesë nga Huamarrësi për tërheqje në bazë të raporteve të Menaxhimit të Projektit, tërheqjet do të bëhen në përputhje me dispozitat e Shtojcës A të Skedulit 1; dhe

(b) me marrjen nga Shoqata të një Raporti të Menaxhimit të Projektit në bazë të Seksionit 4.02 (b) të kësaj Marrëveshjeje, të shoqëruar me një kërkesë nga Huamarrësi për tërheqje në bazë të Raporteve të Menaxhimit të Projektit, të gjitha tërheqjet e mëtejshme do të bëhen në përputhje me dispozitat e Shtojcës B të Skedulit 1.

3. Pagesat nëpërmjet Llogarisë Speciale do të bëhen eksluzivisht për shpenzime të pranueshme/legjitime. Për çdo pagesë të bërë nga Huamarrësi nëpërmjet Llogarisë Speciale, Huamarrësi duhet që, në kohën që do ta kërkojë Shoqata në mënyrë të arsyeshme, t'i paraqesë Shoqatës të gjithë dokumentacionin dhe evidenca të tjera që tregojnë se kjo pagesë është bërë ekskluzivisht për shpenzime të pranueshme/legjitime.

4. Megjithë dispozitat e Pjesës B.2 të këtij Skeduli, Shoqatës nuk do t'i kërkohet të bëjë depozita të tjera në Llogarinë Speciale:

(a) në rast se Shoqata vendos në çdo kohë se Raporti i Menaxhimit të Projektit nuk jep informacionin e duhur të kërkuar në zbatim të Seksionit 4.02 të kësaj Marrëveshjeje;

(b) në rast se Shoqata vendos në çdo kohë se të gjitha tërheqjet e mëtejshme duhen të bëhen nga Huamarrësi drejtpërdrejt nga Llogaria e Kreditit; ose

(c) në rast se Huamarrësi nuk do t'i ketë dhënë Shoqatës, brenda periudhës së specifikuar në Seksionin 4.01 (b) (ii) të kësaj Marrëveshjeje, ndonjë pjesë të raporteve të kontrollit financiar të kërkuara për t'iu dhënë Shoqatës në zbatim të Seksionit të përmendur, në lidhje me kontrollin financiar të (A) rakordimeve dhe llogarive për Llogarinë Speciale ose (B) rakordimeve dhe llogarive që pasqyrojnë shpenzimet, në lidhje me të cilat u bënë tërheqjet në bazë të Raporteve të Menaxhimit të

Projektit.

5. Shoqatës nuk do t'i kërkohet të bëjë depozitime të tjera në Llogarinë Speciale, sipas dispozitave të Pjesës B.2 të këtij Skeduli në rast se, në çdo kohë, Shoqata do të ketë njoftuar Huamarrësin për qëllimin e saj për pezullimin, plotësisht ose pjesërisht, të së drejtës së Huamarrësit për të bërë tërheqje nga Llogaria e Kreditit në zbatim të Seksionit 6.02 të Kushteve të Përgjithshme. Pas këtij njoftimi, Shoqata do të vendosë, nën arsyetimin e vetëm të saj, nëse mund të bëhen depozitime të tjera në Llogarinë Speciale dhe çfarë procedurash duhen ndjekur për t'i bërë depozitime dhe për këtë vendim njofton Huamarrësin.

6. (a) Në rast se Shoqata vendos, në çdo kohë, se një pagesë nga Llogaria Speciale është bërë për një shpenzim që nuk është shpenzim legjitim/i pranueshëm ose nuk ishte i justifikuar në bazë të evidencave të dhëna nga Shoqata, Huamarrësi duhet që, menjëherë sapo merr njoftimin e Shoqatës, të paraqesë dokumentet shtesë që mund të kërkohen nga Shoqata ose të depozitojë në Llogarinë Speciale (ose, në rast se kërkohet nga Shoqata, të rifinancojë Shoqatën) me një shumë të barabartë shumën e kësaj pagese. Në rast se Shoqata nuk bie dakord ndryshe, në Llogarinë Speciale nuk bëhet

asnjë depozitim tjetër nga Shoqata, deri sa Huamarrësi t'i ketë paraqitur këto dokumente ose të ketë bërë këtë depozitim ose rifinancim sipas rastit.

(b) Në rast se Shoqata vendos, në çdo kohë, të mos kërkohet një shumë e zbuluar në Llogarinë Speciale për të mbuluar pagesat për shpenzime të pranueshme gjatë periudhës gjashtë-mujore pas këtij vendimi, Huamarrësi duhet që, menjëherë pas marrjes së këtij njoftimi nga Shoqata, të rifinancojë Shoqatën me këtë shumë të zbuluar.

(c) Duke njoftuar Shoqatën, Huamarrësi mund ta rifinancojë Shoqatën me të gjitha ose një pjesë të fondeve të depozutara në Llogarinë Speciale.

(d) Rifinancimet për Shoqatën, në zbatim të nënparagrafeve (a), (b) ose (c) të këtij paragrafi 6, do t'i kreditohen Llogarisë së Kreditimit për tërheqje të mëpasme ose për anulim në pajtim me dispozitat e Marrëveshjes së Kredisë së Zhvillimit.

ANEKSI A

i

SKEDULIT 1
VEPRIMET ME LLOGARINË E VEÇANTË KUR TËRHEQJET NUK BËHEN
NË BAZË TË RAPORTEVE TË MENAXHIMIT TË PROJEKTIT

1. Për qëllimet e këtij Aneksi:

(a) termi "Shumë e Autorizur" do të thotë një shumë e barasvlefshme me $500,000 që duhet të tërhiqet nga Llogaria e Kreditimit dhe do të depozitohet në Llogarinë Speciale në zbatim të paragrafit 2 të këtij Aneksi; sidoqoftë, me kusht që, në rast se Shoqata nuk bie dakord ndryshe, Shuma e Autorizuar do të kufizohet në shumën ekuivalente prej $250,000 deri sa shuma agregate e tërheqjeve nga Llogaria e Kreditimit, plus shumën e përgjithshme e të gjitha angazhimeve të veçanta

të mbetura në të cilat ka hyrë Shoqata në zbatim të Seksionit 5.02 të Kushteve të Përgjithshme të jetë e barabartë me ekuivalentin prej SDR 2,500,000.

2. Tërheqjet nga Shuma e Autorizuar e Llogarisë së Veçantë dhe tërheqjet e mëpasme për të plotësuar Llogarinë Speciale do të bëhen si më poshtë:

(a) Për tërheqjet e shumës së Autorizuar nga Llogaria Speciale, Huamarrësi do t'i bëjë Shoqatës një kërkesë ose disa kërkesa për depozitim në Llogarinë Speciale të një shume ose shumave të cilat, në total, nuk e kalojnë Shumën e Autorizuar. Në bazë të çdo kërkese të tillë, Shoqata do të tërheqë, në emër të Huamarrësit, nga Llogaria e Kreditimit dhe do të depozitojë në Llogarinë Speciale atë shumë që do të ketë kërkuar Huamarrësi.

(b) Për plotësimin e Llogarisë Speciale, Huamarrësi do t'i bëjë Shoqatës kërkesa për depozotim në Llogarinë Speciale në ato intervale që mund të specifikohen nga Shoqata. Para ose në kohën e secilës prej këtyre kërkesave, Huamarrësi i paraqet Shoqatës dokumentacionin dhe evidencat e kërkuara në zbatim të Pjesës B.3 të Skedulit 1 të kësaj Marrëveshjeje për pagesën ose pagesat në lidhje me të cilat kërkohet plotësim. Në bazë të secilës prej këtyre kërkesave, Shoqata do të tërheqë nga Llogaria e Kreditit, në emër të Huamarrësit, dhe depozitojë në Llogarinë Speciale atë shumë që mund të ketë kërkuar Huamarrësi dhe që do të jetë treguar në dokumentacionin dhe evidencat e mësipërme se janë paguar nga Llogaria Speciale për shpenzimet legjitime/të pranueshme. Secila prej

këtyre derdhjeve në Llogarinë Speciale do të tërhiqet nga Shoqata nga Llogaria e Kredisë sipas një a më shumë kategorive legjitime/ të pranueshme të Llogarisë Speciale.

3. Shoqatës nuk do t'i kërkohet të bëjë derdhje të tjera në Llogarinë Speciale kur shuma e përgjithshme e patërhequr e Kreditit të caktuar për kategorinë legjitime/të pranueshme të Llogarisë Speciale minus shumën e përgjithshme të angazhimeve të veçanta të zbuluara, të lidhura nga Shoqata, në zbatim të Seksionit 5.02 të Kushteve të Përgjithshme, do të jetë e barabartë me dyfishin e shumës së shumës së autorizuar të Llogarisë Speciale. Që këtej, tërheqja nga Llogaria e Kreditimit e shumës së mbetur të patërhequr të Kreditit do të ndjekë ato procedura që do të specifikojë Shoqata dhe për të cilat do të njoftojë Huamarrësin. Këto tërheqje të mëtejshme do të bëhen vetëm pasi dhe në masën që Shoqata të jetë e kënaqur, se të gjitha ato shuma që kanë mbetur në depozitë në Llogarinë Speciale, që nga data e këtij njoftimi do të përdoren për bërjen e pagasave për shpenzime legjitime/të pranueshme.

ANEKSI B

i

SKEDULIT 1
VEPRIMET ME LLOGARINË SPECIALE
KUR TËRHEQJET BËHEN NË BAZË TË RAPORTEVE TË MENAXHIMIT TË PROJEKTIT

1. Përveç rasteve kur specifikohet ndryshe nga Shoqata dhe njoftimit të Huamarrësit në lidhje me këtë, të gjitha tërheqjet nga Llogaria e Kreditimit do të depozitohen nga Shoqata në Llogarinë Speciale, në përputhje me dispozitat e Skedulit 1 të kësaj Marrëveshjeje. Shoqata do të tërheqë çdo derdhje të tillë dhe në Llogarinë Speciale nga Llogaria e Kreditimit, sipas një a më shumë kategorive legjitime të pranueshme të Llogarisë Speciale.

2. Çdo kërkesë për tërheqje nga Llogaria e Kreditimit për depozitim në Llogarinë Speciale do të shoqërohet me një Raport të Menaxhimit të Projektit.

3. Me marrjen e kësaj kërkese për tërheqje të një shume të Kredisë, Shoqata do të tërheqë, në emër të Huamarrësit, nga Llogaria e Kreditimit dhe do të depozitojë në Llogarinë Speciale një shumë të barabartë me më pak se: (a) shuma e kërkuar; dhe (b) shuma që ka përcaktuar Shoqata, bazuar në Raportin e Menaxhimit të Projektit, që shoqëron kërkesën e mësipërme, kërkohet të depozitohet me qëllim që të financohen shpenzimet legjitime gjatë periudhës gjashtëmujore pas së këtij raporti; megjithatë, me kusht që shuma e depozituar, kur t'i shtohet shumës së treguar nga Raporti i mësipërm i Menaxhimit të Projektit që mbetet në Llogarinë Speciale të mos e kalojë ekuivalentin e $ 500.000.

SKEDULI 2
PËRSHKRIMI I PROJEKTIT

Objektivi i Projektit është përmirësimi i standardeve të jetesës për të varfërit dhe grupet vulnerabël të Huamarësit përmes: (i) rritjes së aksesit të tyre ndaj shërbimeve efikase të përkujdesjes sociale; dhe (ii) ndihmesës që do t'i jepet Huamarrësit për të zhvilluar politika efektive të përkujdesjes sociale dhe për të përmirësuar kapacitetin e Huamarrësit në shpërndarjen dhe monitorimin e shërbimeve të përkujdesjes sociale.

Projekti përbëhet nga pjesët e mëposhtme, gjithmonë të modifikueshme, në rast se Huamarrësi dhe Shoqata mund të bien dakord nga koha në kohë për të arritur këto objektiva:

Pjesa A. Zhvillimi i politikave

1. Sigurimi i pajisjeve, trajnimit dhe shërbimeve të konsulentëve për të mbështetur kuadrin institucional, si edhe për të zhvilluar kapacitetet e Huamarrësit në mbledhjen, analizimin dhe shpërndarjen në kohë të informacionit statistikor të përshtatshëm në nivel familjeje për monitorimin e varfërisë dhe vlerësimin e programeve sociale.

2. Sigurimi i trajnimit dhe shërbimeve të konsulencës për zhvillimin e kapacitetit të Huamarrësit në zhvillimin e politikave, duke përfshirë: (a) vendosjen e standardeve për shërbimet e përkujdesjes sociale dhe monitorimin e këtyre standardeve; (b) shpërndarjen e informacionit publik me qëllim propagandimin dhe hartimin e programeve "outreach" mbi problemet e përfshirjes sociale; (c) zhvillimin e kuadrit ligjor dhe rregullator, si edhe përcaktimin e përgjegjësive për monitorimin dhe administrimin e shërbimeve të përkujdesjes sociale; (d) zhvillimin e një sistemi dhe kuadri të qëndrueshëm financiar për pjesëmarrjen dhe koordinimin e donatorëve në financimin e shërbimeve të

përkujdesjes sociale me bazë komuniteti.

3. Sigurimi i shërbimeve të konsulencës dhe trajnimit në mbështetje të përdorimit efektiv të mjeteve/instrumenteve aktuale për modelimin e politikës së pensioneve dhe vlerësimin e varianteve të mundshme për reformën.

Pjesa B. Monitorimi dhe administrimi i shërbimeve sociale

1. Sigurimi i pajisjeve, shërbimeve të konsulencës dhe trajnimit, me qëllim përmirësimin e kapaciteteve të Huamarrësit për monitorimin dhe administrimin e shërbimeve sociale me bazë komuniteti.

2. Sigurimi i shërbimeve të konsulencës dhe trajnimit për thellimin e kapacitetit të Huamarrësit për trajnimit për punën sociale, si edhe për zhvillimin e një sistemi për trajnim me baza të rregullta të punonjësve socialë në ofrimin e shërbimeve sociale me bazë komuniteti.

Pjesa C: Shërbime sociale me bazë komuniteti

1. Sigurimi i Granteve për nënprojekte, me qëllim krijimin e shërbimeve sociale me bazë komuniteti për grupet e synuara të popullatës mbi bazën e kritereve të legjitimitetit/përshtatshmërisë të përcaktuara në Manualin e Punës (operacional), si edhe mbi bazën e procedurës dhe krietereve për përzgjedhjen e nënprojekteve të vendosura në Skedulin 5 të kësaj Marrëveshjeje.

2. Sigurimin e shërbimeve të konsulencës dhe trajnimit për pushtetin lokal dhe ofruesit e shërbimeve me qëllim menaxhimin e shërbimeve sociale me bazë komuniteti, punën sociale dhe menaxhimin e rasteve.

Pjesa D: Menaxhimi dhe monitorimi i Projektit

Sigurimi i pajisjeve, trajnimit, shërbimeve të konsulencës dhe kostove inkrementale operacionale për t'i ardhur në ndihmë zbatimit efektiv të aktivtiteteve të Projektit, si edhe zhvillimit të sistemit të monitorimit dhe menaxhimit të informacionit të Projektit.

***

Projekti është parashikuar të përfundojë më 30 shtator 2001.

SKEDULI 3
PROKURIMET DHE SHËRBIMET E KONSULENCËS

Seksioni 1. Prokurimi i mallrave dhe punimeve

Pjesa A: Të përgjithshme

1. Mallrat dhe punimet do të prokurohen në përputhje me (a) dispozitat e Seksionit të materialit "Udhëzime për prokurimin sipas Huave të BERZH-it dhe Kredive të IDA-s", botuar nga Banka në janar 1995 dhe ripunuar në janar dhe gusht 1996, shtator 1997 dhe janar 1999 (Udhëzimet), si edhe dispozitat e pjesëve vijuese të këtij Seksioni I.

2. Në paragrafet 1.6 dhe 1.8 të Udhëzimeve, emërtimet "vendet anëtare të Bankës" dhe "vend anëtar" do të merren, përkatësisht, njësoj si emërtimet "vende pjesëmarrëse" dhe "vend pjesëmarrës".

Pjesa B. Tender konkurrues ndërkombëtar

1. Përveç asaj që parashikohet ndryshe në Pjesën C të këtij Seksioni, mallrat dhe punimet do të prokurohen, në bazë të kontratave të lidhura në përputhje me dispozitat e Seksionit II të udhëzimeve dhe paragrafit 5 të Aneksit I të tyre.

2. Dispozitat e mëposhtme do të zbatohen për mallrat dhe punimet që duhet të prokurohen, në bazë të kontratave të lidhura në përputhje me dispozitat e paragrafit 1 të kësaj Pjese B.

a) Preferenca për mallra të prodhuara në vend dhe kontraktorë vendas.

Dispozitat e paragrafeve 2.54 dhe 2.55 të udhëzimeve dhe Aneksit 2 të tyre do të zbatohen për mallrat e prodhuar në territorin e Huamarrësit dhe për punimet që do të kryhen nga kontraktorë vendas.

Pjesa C: prodecura të tjera prokurimi

1. Tender konkurrues kombëtar

Mallrat që llogaritet se kushtojnë më pak se ekuivalenti $ 100.000 për kontratë deri në një shumë të përgjithshme që të mos e kalojë ekuivalentin $ 2,200 000, mund të blihen sipas kontratave të lidhura sipas dispozitave të paragrafeve 3,5 dhe 3,4 të udhëzimeve.

2. Blerja ndërkombëtare

Mallrat që llogaritet se kushtojnë më pak se ekuivalenti $ 100,000 për kontratë deri në një shumë të përgjithshme që të mos e kalojë ekuivalentin $ 100,000 mund të prokurohen sipas kontratave

të lidhura në bazë të procedurave të blerjes ndërkombëtare, në përputhje me dispozitat e paragrafeve 3.5 dhe 3.6 të udhëzimeve.

3. Blerjet kombëtare

Mallrat që llogaritet se kushtojnë më pak se ekuivalenti $ 25.000 për kontratë, deri në një shumë të përgjithshme që të mos e kalojë ekuivalentin $ 1.000.000 mund të blihen sipas kontratave të lidhura në bazë të procedurave të blerjes kombëtare, në përputhje me dispozitat 3.5 dhe 3.6 të udhëzimeve.

4. Prokurimi nga agjenci të Kombeve të Bashkuara

Si alternativë për blerjen, prokurimi i mallrave mund të kryhet edhe përmes Zyrës së Shërbimeve të Prokurimet Ndëragjenci (IAPSO) të Programit për Zhvillim të Kombneve të Bashkuara (UNDP) në përputhje me paragrafin 3.9 të udhëzimeve.

5. Prokurimi i punimeve të vogla

Punimet që mendohen të kushtojnë më pak se ekuivalenti i $ 20.000 për kontratën deri në një shumë agregate që nuk duhet të kalojë ekuivalentin 500.000 mund të prokurohen përmes kontratave me një shumë të vetme (lump-sum) apo me çmim fiks të lidhura mbi bazën e kuotimeve nga tri (3) kontraktorë të kualifikuar vendas në përgjigje të një ftese me shkrim. Ftesa do të përmbajë një përshkrim të detajuar të punimeve, duke përfshirë specifikimet bazë, datën në të cilën kërkohet të mbarojë ky punim, një formular bazë marrëveshjeje të pranueshme për Shoqatën, si edhe skica të caktuara, në ato raste kur këto janë të aplikueshme. Kontrata do t'i jepet atij kontraktori i cili ofron kuotimin me çmimin më të ulët për punën që kërkohet dhe i cili ka eksperiencën dhe burimet për ta përfunduar me sukses kontratën.

Pjesa D. Rishikimi i vendimeve të prokurimeve nga Shoqata

1. Planifikimi i prokurimit

Përpara dërgimit të ftesave për oferta për kontrata, plani i propozuar për prokurim për Projektin do t'i jepet Shoqatës për shqyrtim dhe aprovim, në përputhje me dispozitat e paragrafit 1 të Apendiksit 1 të udhëzimeve. Prokurimi i të gjitha mallrave dhe punimeve do të kryhet në përputhje me planin e prokurimeve të aprovuara nga Shoqata, si edhe me dispozitat e paragrafit 1.

2. Shqyrtimi paraprak

(a) Në lidhje me secilën nga kontratat e Pjesës B, përsa i takon pesë kontratave të para në paragrafin 1 të Pjesës C dhe përsa i takon tri kontratave të para në paragrafin 5 të Pjesës C, do të zbatohen procedurat e përcaktuara në paragrafet 2 dhe 3 të Shtojcës I të Udhëzimeve.

(b) Përsa i takon tri kontratave të paragrafeve 2 dhe 3 të Pjesës B do të aplikohen procedurat e mëposhtme:

(i) përpara përzgjedhjes së çfarëdo furnitori sipas procedurave të blerjes (shopping), Huamarrësi do t'i dorëzojë Shoqatës një raport mbi krahasimin dhe vlerësimin e kuotimeve të marra;

(ii) përpara zbatimit të çfarëdo kontrate të prokuruar sipas procedurave të blerjes (shopping), Humarrësi do t'i paraqesë Shoqatës një kopje të specifikimeve dhe projekt-kontratës; dhe

(iii) do të aplikohen procedurat e përcaktuara në paragrafet 2 (f), 2(g) dhe 3 të Shtojecës 1 të udhëzimeve.

3. Shqyrtimi i mëpasshëm

Procedurat e përcaktuara në paragrafin 4 të Shtojcës 1 do të zbatohen në lidhje me çdo kontratë që nuk udhëhiqet nga paragrafi 2 i kësaj Pjese.

Seksioni II. Punësimi i konsulentëve

Pjesa A: Të përgjithshme

1. Shërbimet e konsulencës do të prokurohen në përputhje me (a) dispozitat e Hyrjes dhe të Seksionit IV të materialit "Udhëzimet: Përzgjedhja dhe Pajtimi i Konsulentëve nga Huamarrësit e Bankës Botërore", botuar nga Organizata në janar 1997 dhe rishikuar në shtator 1997 dhe janar 1999, në varësi të ndryshimeve të bëra të përcaktuara në paragrafin 2 të kësaj Pjese A (Udhëzimet për Konsulentët) dhe (b) dispozitat e Pjesëve vijuese të këtij Seksioni II.

2. Në paragrafet 1.10 të Udhëzimeve për Konsulentët, emërtimet "vende anëtare të Bankës" dhe "vend anëtar" do të merren, përkatësisht, njësoj si emërtimet "vende pjesëmarrëse" dhe "vend pjesëmarrës".

Pjesa B: Përzgjedhja mbi bazën e cilësisë dhe kostos

Përveç asaj që parashikohet ndryshe në Pjesën C të këtij Seksioni, shërbimet e konsulentëve do të prokurohen në bazë të kontratave të lidhura në përputhje me dispozitat e Seksionit II të

Udhëzimeve për Konsulentët, paragrafi 3 i Shtojcës 1 të tyre, Shtojcës 2 të tyre dhe dispozitat e paragrafeve 3.13 deri në 3.18 të tyre të zbatueshme për përzgjedhjen e konsulentëve sipas cilësisë dhe kostos.

Pjesa C. Procedurat e tjera për përzgjedhjen e konsulentëve

1. Përzgjedhje mbi bazën e kualifikimit të konsulentëve

Shërbimet për hartimin e standardeve, planifikimit, ngritjen e kapaciteteve dhe administrimin e menaxhimit të rasteve pritet të kushtojnë më pak se ekuivalenti i $ 100.000 për kontratë mund të prokurohen sipas kontratave të lidhura në përputhje me dispozitat e paragrafeve 3.1 dhe 3.7 të udhëzimeve për konsulentët.

2. Konsulentë individualë

Shërbimet për detyra që i plotësojnë kërkesat e parashikuara në paragrafin 5.1 të Udhëzimeve për Konsulentët, do të prokurohen në bazë të kontratave të lidhura me konsulentë të veçantë në përputhje me dispozitat e paragrafeve 5.1 deri në 5.3 të Udhëzimeve për Konsulentët.

Pjesa D: Shqyrtimi nga Shoqata i Përzgjedhjes së Konsulentëve

1. Planifikimi i përzgjedhjes

Përpara nxjerrjes të ndonjë kërkese për propozime për konsulentët, plani i propozuar për përzgjedhjen e konsulentëve në bazë të Projektit do t'i paraqitet Shoqatës për kontrollin dhe miratimin e saj, sipas dispozitave të paragrafit 1 të Shtojcës 1 të Udhëzimeve për Konsulentët. Përzgjedhja e shërbimeve të konsulentëve do të ndërmerret në përputhje me planin e përzgjedhjes që do të miratohet nga Shoqata dhe me dispozitat e paragrafit 1 të përmendur.

2. Shqyrtimi paraprak

(a) Në lidhje me çdo kontratë për pajtimin e firmave të konsulentëve për pjesën B dhe paragrafin I të Pjesës C, do të zbatohen procedurat e parashikuara në paragrafet 1,2 (dhe jo nënparagrafi i tretë i paragrafit 2(a) dhe 5 të Shtojcës 1 të Udhëzimeve për Konsulentët).

(b) Në lidhje me pesë kontratat e para për pajtimin e konsulentëve të veçantë për paragrafin 2 të Pjesës C, kualifikimet, përvoja termat e referencës dhe kushtet e pajtimit të konsulentëve do t'i paraqiten Shoqatës për rishikim dhe miratim paraprak. Kontrata do të lidhet vetëm pasi të jetë marrë miratimi i mësipërm.

3. Rishikimi më pas

Në lidhje me çdo kontratë që nuk qeveriset nga paragrafi 2 i kësaj Pjese do të zbatohen procedurat e parashikuara në paragrafin 4 të Shtojcës 1 të Udhëzimeve për Konsulentët.

SKEDULI 4
PROGRAMI I ZBATIMIT

1. Huamarrësi:

(a) do të mbajë politikat dhe procedurat në mënyrë të tillë që të jetë i mundur monitorimi dhe vlerësimi i vazhdueshëm i tyre, në përputhje me tregues të kënaqshëm për Shoqatën, zbatimin dhe arritjet e objektivave të tij.

(b) do të përgatisë, sipas Termave të Referencës të kënaqshme për Shoqatën, dhe do t'i paraqesë Shoqatës në datën 30 shtator 2004 ose rreth kësaj date, një raport ku të përfshihen rezultatet e monitorimit dhe vlerësimit sipas paragrafit (a) të këtij Seksioni, në lidhje me progresin e arritur gjatë zbatimit të Projektit në periudhën përpara datës së këtij raporti dhe të caktojë masat e rekomanduara për të siguruar zbatimin efektiv të Projektit dhe arritjen e objektivave të caktuar gjatë periudhës pas kësaj date; dhe

(c) do të shqyrtojë me Shoqatën, deri më 31 dhjetor 2004, apo në ndonjë datë të mëvonshme që do të kërkohet nga Shoqata, raportin të cilit i referohet paragrafi (b) i këtij Seksioni dhe më pas të marrë të gjitha masat që kërkohen për të siguruar përfundimin efikas të Projektit dhe arritjen e objektivave të tij mbi bazën e konkluzioneve dhe rekomandimeve të këtij raporti në fjalë, si edhe mbi mendimet/opinionin e Shoqatës në lidhje me çështjen.

2. Humarrësi do të përgatisë dhe do t'i dorëzojë Shoqatës një program vjetor pune për projektin deri më datën 1 mars të çdo viti.

3. Huamarrësi:

(a) do të përfundojë një vlerësim të parë të përfituesve dhe do t'ia dërgojë Shoqatës deri më 31 dhjetor 2003 një raport për vlerësimin e impaktit të përfituesve; dhe

(b) do të kryejë një vlerësim të impaktit të përfituesve çdo 2 vjet dhe do t'ia dërgojë Shoqatës deri më 30 qershor të vitit në vazhdim një raport të vlerësimit të impaktit tek përfituesit.

4. Huamarrësi:

(a) do të përfundojë prokurimin e parë dhe auditimin teknik do t'ia paraqesë Shoqatës deri më 31 dhjetor 2004 raportin e prokurimit dhe auditimit teknik; dhe

(b) do të kryejë auditimin përfundimtar teknik dhe prokurimin dhe do t'ia paraqesë Shoqatës deri më 30 prill 2007.

5. Deri më 31 dhjetor 2001, Huamarrësi do t'i bëjë amendament vendimit nr.52, datë 8 gusht 1996 në lidhje me Administratën e Përgjithshme të Ndihmës dhe Shërbimeve Sociale, me qëllim për të ripërcaktuar rolin e APNSHS-së në monitorimin dhe administrimin e këtyre shërbimeve.

6. Humarrësi, deri më datë 31 tetor 2001, duhet të ketë instaluar versionin e parë të "software"-it MIS.

7. Huamarrësi do të alokojë çdo vit fondet e kërkuara gjatë vitit fiskal për zbatimin e Projektit.

8. Deri në përfundimin e Projektit, Huamarrësi do të mbajë PCU-në me burime staf dhe terma reference të kënaqshme për Shoqatën.

SKEDULI 5
PROCEDURA DHE KRITERET PËR PËRZGJEDHJEN E NËNPROJEKTEVE

1. APNSHS-ja qendrore dhe PCU-ja do të përgjigjet për përzgjedhjen e propozimeve për nënprojekte.

2. Zyra rajonale e APSH-së do të fillojë fushatën e promovimit, ndjekur nga botimi i kërkesave për propozime për nënprojekte, në bashkëpunim me pushtetin rajonal për të ftuar bashkitë, sektorin privat dhe OJQ-të që sigurojnë shërbime sociale.

3. Aplikanti do të duhet të përmbushë kriteret e parapërzgjedhjes të përcaktuara në Manualin Operacional në lidhje me: (a) përputhshmërinë me kërkesat për dokumentacion; (b) grupet e përfituesve të synuar; (c) llojet e projekteve të përshtatshme për financim; dhe (d) shumën dhe bashkëfinancimin. Kontributi i pushtetit lokal do të jetë së paku 10% të kostos së investimit dhe 100% të kostos korrente të nënprojektit.

4. Zyra rajonale e APSH-së do të vlerësojë propozimet mbi bazën e sa më poshtë: (a) ndikimin e tij në shoqëri; (b) kapaciteti institucional për zbatimin e shërbimeve të parashikuara nga granti; (c) leverdisshmëria financiare dhe (d) parametrat teknikë dhe ato të mjedisit.

5. Zyra rajonale e APSH-së do t'i dërgojë raportin me përmbledhjen e propozimeve në APNSHS-së qendrore dhe PCU-në.

6. PCU-ja do të regjistrojë rezultatet në Sistemin e Menaxhimit të Informacionit të Projektit dhe do t'i dërgojë raportet përmbledhëse në Komitetin Rajonal të Aprovimit për aprovimin final të propozimeve për nënprojektet e përzgjedhura.